



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

Prefekti Qarkut Fier
Nr. 730 Prot.
Datë, më 02.04.2025

U R D H Ë R

Nr. 94, datë 27.6.2025

PËR

NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETEVE RAJONALE
ANTITRAFIKIM

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe planit të veprimit 2023-2025”, të ndryshuar,

U R D H Ë R O J:

1. Ngritja dhe funksionimi i komiteteve rajonale antitrafikim

1.1. Ngritjen dhe funksionimin e komiteteve rajonale antitrafikim (në vijim, KRAT) në të gjitha qarqet e Republikës së Shqipërisë, për të mbështetur e koordinuar përpjekjet për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të genieve njerëzore, në nivel vendor e rajonal.

1.2. Çdo KRAT të funksionojë nën drejtimin e prefektit të Qarkut dhe të përbëhet nga drejtuesit e institucioneve vendore ose përfaqësues të tyre, përkatësisht nga:

- Këshilli i Qarkut;
- Nënprefekti i Qarkut;
- Drejtoria Vendore e Policisë;
- Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit;
- njësia vendore e kujdesit shëndetësor;
- spitali rajonal;

- Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar;
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
- Shërbimi Social Shtetëror;
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive;
- Shërbimi Informativ i Shtetit;
- shërbimet sociale në nivel vendor;
- strukturat e migracionit dhe diasporës pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.

- 1.3. Me qëllim funksionimin sa më të mirë të KRAT-it dhe zbatimin e politikave antitrafikim, prefekti i Qarkut, në cilësinë e kryetarit, të nënshkruajë memorandum/protokolle bashkëpunimi me prokuroritë përkatëse të gjykatës së shkallës së parë/apelit me juridiksion të përgjithshëm, si dhe me organizata joshtetërore, anëtare ose jo të Mekanizmit Kombëtar të Referimit.
- 1.4. Në takimet e KRAT-it të ftohen të marrin pjesë, sipas nevojave, përfaqësues nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, organizata me ekspertizë/të specializuara në fushën e antitrafikut, si dhe përfaqësues të tjerë, sipas nevojave specifike që mund të paraqiten rast pas rasti.
- 1.5. Në nivel qarku, të ngrihen e të funksionojnë tryeza teknike antitrafikim, që të kryesohen nga sekretari i përgjithshëm i institucionit të prefektit të Qarkut dhe të kenë në përbërje përfaqësues teknikë nga secili institucion/strukturë/organizatë, që është pjesë përbërëse e KRAT-it.
- 1.6. Tryeza teknike antitrafikim të mbledhet një herë në dy muaj/ose, në raste emergjence, edhe më shpesh dhe të ketë këto detyra:
 - a) Identifikon problemet parësore në fushën e antitrafikut;
 - b) Mbledh e shkëmben të dhëna mbi identifikimin fillestar, referimin dhe zgjidhjen e rasteve konkrete;
 - c) Përcakton veprimet e nevojshme për parandalimin e trafikimit, mbrojtjen e familjeve, grupeve, personave dhe fëmijëve në rrezik trafikimi;
 - ç) Organizon veprimtaritë/aktivitetet ndërgjegjëse në bashkëpunim me aktorë të tjerë shtetërorë dhe joshtetërorë për parandalimin e trafikimit;
 - d) Raporton me shkrim pas çdo mbledhjeje pranë KRAT-it përkatës lidhur me veprimtarinë e tryezës teknike antitrafikim, gjetjet,

ecurinë e rasteve të trajtuara, si dhe adreson rekomandime për zgjidhje;

dh) Organizon ngritjen e grupeve teknike antitrafik në nivel bashkie apo njësie administrative.

1.7. Çdo KRAT të mbështetet nga sekretariati teknik, rolin e të cilit e kryen një strukturë pranë institucionit të prefektit të Qarkut, e cila të përbëhet nga 3 (tre) persona dhe të kryejë këto detyra:

- a) Bashkërendon punën me të gjithë anëtarët e KRAT-it dhe të tryezës teknike antitrafikim lidhur me njoftimin, agjendën dhe mbarëvajtjen e takimeve, si dhe siguron grumbullimin e shkëmbimin e materialeve për takimet e planifikuara;
- b) Kujdeset për realizimin e detyrave të përcaktuara në mbledhjet/takimet e mëparshme të KRAT-it dhe të tryezës teknike antitrafikim;
- c) Siguron mbledhjen e shkëmbimin e të dhënave në nivel qarku për detyrat në fushën e antitrafikut dhe i administron ato për raste konkrete të trajtuara në tryezat teknike antitrafikim, si dhe i përcjell pranë strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme;
- ç) Harton raportet periodike të veprimtarisë së KRAT-it dhe të tryezës teknike antitrafikim dhe e paraqet për miratim në KRAT-in përkatës.

2. Funksionet e Komitetit Rajonal Antitrafikim

2.1. KRAT-i ka për detyrë të planifikojë, të koordinojë dhe të zbatojë masat për:

- a) parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit dhe aktiviteteve edukative;
- b) identifikimin e hershëm të viktimave të mundshme të trafikimit nëpërmjet trajnimit të stafit vendor dhe bashkëpunimit me komunitetin;
- c) promovimin e bashkëpunimit ndërkufitar në luftën kundër trafikimit;
- ç) hartimin e programeve për menaxhimin e rasteve emergjente;
- d) sigurimin e mbrojtjes, rehabilitimit dhe riintegrit të viktimave të trafikimit, në bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe organizatat;

- dh) shkëmbimin e informacionit dhe të të dhënave ndërmjet institucioneve për identifikimin e ndjekjen penale të rrjeteve të trafikimit;
- e) monitorimin e situatës vendore lidhur me trafikimin e raportimin periodik te Ministria e Brendshme dhe strukturat e tjera qendrore.

2.2. KRAT-i të zhvillojë mbledhje periodike (jo më pak se një herë në tre muaj) për të diskutuar progresin e veprimtarisë së tij dhe për të planifikuar veprimet e ardhshme. Në raste emergjente, KRAT-i mund të organizojë mbledhje të jashtëzakonshme.

3. Raportimi, koordinimi dhe monitorimi

- 3.1. Çdo KRAT të hartojë e të paraqesë raporte tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore për aktivitetet/veprimtarinë e tij dhe situatën vendore lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore pranë Ministrisë së Brendshme.
- 3.2. Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me institucione të tjera qendrore, të ofrojë mbështetje dhe udhëzime për funksionimin efektiv të KRAT-it dhe të sigurojë mbikëqyrjen e vlerësimin e progresit të tyre.
- 3.3. Struktura përgjegjëse për antitrafikun në Ministrinë e Brendshme të monitorojë zbatimin e këtij urdhri dhe performancën e KRAT-it, duke i reflektuar në raporte periodike vjetore.

4. Mbrojtja e konfidencialitetit

Të gjitha të dhënat personale dhe informacionet që lidhen me viktimat e trafikimit të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë. KRAT-i ka përgjegjësinë për të siguruar që këto të dhëna të trajtohen në mënyrë të sigurt e konfidenciale.

5. Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve

Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me organizatat partnere dhe institucionet ndërkombëtare, organizon programe trajnimi dhe shkëmbime eksperiencash/praktika të mira kombëtare dhe ndërkombëtare për anëtarët e KRAT-it dhe të tryezës teknike antitrafikim, përfshirë përfaqësuesit e institucioneve vendore për të përmirësuar kapacitetet e tyre në trajtimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore.


6. Dispozita të fundit

- 6.1. Brenda 15 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, titullarët e institucioneve të përcaktuara në nënpikat 1.2 dhe 1.5 të këtij urdhri, të dërgojnë emrat e përfaqësuesve të tyre në KRAT dhe në tryezat teknike antitrafikim pranë prefektit të Qarkut.
- 6.2. Urdhri nr.6, datë 26.1.2017, i Kryeministrit, “Për krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në çdo qark”, shfuqizohet.
- 6.3. Ngarkohet Komiteti Rajonal Antitrafikim për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

A large, stylized handwritten signature in black ink, which appears to be 'Edi Rama', is written over the printed name. The signature starts with a long horizontal stroke on the left, curves upwards and to the right, then loops back down and to the left, crossing itself before ending with a long horizontal stroke on the right.

NR.PROT.2074/3
DATË 30.6 .2025

TË GJITHA PREFEKTURAVE
TË GJITHA BASHKIVE
TË GJITHË KËSHILLAVE TË QARQEVE
DREJTORIVE RAJONALE
TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT
DHE AFTËSIVE
SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT
TË GJITHA DREJTORIVE VENDORE TË POLICISË
INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS
DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËTOR

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

Me autorizim

Herald JONUZAJ

